



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 414 Akti

Nr. 483 Vendimi

Tiranë, më 9.12.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko
Roland Ilia
Etleda Çiftja

Kryesuese
Relator
Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. **Theo Jakobs**, në datën 7.12.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Znj. Vjosa Zaimi, me detyrë Gjyqtar pranë Gjykatës së shkallës së parë Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Vjosa Zaimi, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Vjosa Zaimi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e shkallës së parë Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në muajin Dhjetor 2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Vjosa Zaimi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.

4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues, komisionere Pamela Qirko, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Vjosa Zaimi.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Vjosa Zaimi, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua Akti i kontrollit me nr. *** prot., datë 11.10.2018, e ILDKPKI-së, protokolluar pranë KPK nr. *** datë 12.10.2018, ku është kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit Vjosa Zaimi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të

Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 3.12.2021 (deklasifikuar plotësisht me vendim nr.***, datë 26.11.2021, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të dhënat e rezultuara nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënat arkivore të KLGJ-së. Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale me nr. *** prot., datë 2.11.2021, për subjektin e rivlerësimit, është protokolluar pranë KPK me nr.*** prot., datë 17.11.2021.

11. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë së figurës dhe vlerësimin profesional, në datën 11.5.2021 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tre kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Vjosa Zaimi; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 24.11.2021 mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti pasi u njoh me aktet e dosjes, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më 3.12.2021.

14. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 3.12.2021, vendosi të ftojë znj. Vjosa Zaimi në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit, znj. Vjosa Zaimi, u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 3.12.2021.

16. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 7.12.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

17. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Vjosa Zaimi, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Znj. Vjosa Zaimi ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision, nga ILDKPKI-ja;
- c) “Deklarata e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) dosjen e administruar për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit (i cili është subjekt i rivlerësimit kalimtar) sipas vendimit të trupës.
- e) përgjigjet e pyetjeve drejtuar subjektit dhe bashkëshortit gjatë komunikimit në kuadër të procesit të rivlerësimit sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016;
- f) raportin e kontrollit të figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- g) raportin e analizimit të aftësive profesionale, të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

¹“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Inspektoriati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë referuar neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016 dhe me shkresën me nr. *** prot., datë 11.10.2018, ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë të subjektit znj. Vjosa Zaimi (Çela), me funksion Gjyqtare pranë Gjykatës së shkallës së parë Tiranë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ka konstatuar se:

- a. *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b. *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar për huamarrjen në shumën 4.700.000 lekë;*
- c. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d. *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Znj. Vjosa Zaimi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me nr. indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, si më vijon: (i) para fillimit të detyrës, vitit 2003; (ii) periodike/vjetore, për vitet 2004-2017; (iii) deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit 84/2016.

Subjekti Vjosa Zaimi ka filluar punë si gjyqtare në nëntor të vitit 2002 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe prej nëntorit të vitit 2011 dhe aktualisht punon si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pjesa më e madhe e të dhënave dhe provave shkresore, lidhur me pasurinë dhe me pyetësorët për këtë subjekt, janë marrë dhe administruar nga dosja e bashkëshortit të subjektit Q.Z, sipas vendimit të trupit gjykues të datës 29.9.2021. Kjo nisur nga fakti se pasuritë e subjektit janë të njëjtat pasuri me ato të bashkëshortit dhe se procedura për bashkëshortin e subjektit (si subjekt rivlerësimi) ka përfunduar me vendimin nr. 321 datë 10.12.2020 të Komisionit.

Lidhur me këtë i është kërkuar subjektit nëse mban të njëjtin qëndrim të përgjigjeve të pyetësorëve të dërguar nga bashkëshorti gjatë procesit të rivlerësimit të tij.

Në përgjigje të pyetësorit² subjekti ka deklaruar se i përmbahet përgjigjeve të dhëna nga bashkëshorti i saj gjatë procesit të rivlerësimit.

Në deklaratën “Vetting” të dorëzuar pranë ILDKPKI, më datë 24 Janar 2017, subjekti dhe personat e lidhur, kanë deklaruar pasuritë si vijojnë:

² Shiko përgjigjen e pyetësorit nr.2 të dërguar nga subjekti i rivlerësimit

1. Automjet, tip “Peugeot” model 206, viti i prodhimit 2009, me targa TR ***U

1.1 Subjekti ka deklaruar pasurinë automjet e llojit Pezho³ (Peugeot) model 206, viti i prodhimit 2009, me targa TR***U. Vlera 1.172.830 lekë. Zotërimi 50%.

Burimi i krijimit janë deklaruar: Të ardhurat e kursyera nga paga e subjektit dhe bashkëshortes.

Hetimi i kryer nga Komisioni

1.2 Rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, me kontratë (jo noteriale) nr. ***, datë 28.6.2010⁴, ka blerë nga shoqëria “****” automjetin Peugeot në vlerën 8.575⁵ euro. Për këtë blerje është depozituar faturë tatimore pa numër dhe datë, në vlerën prej 8.575 euro (rreth 1,172,830 lekë).

1.3 DPSHTRR me shkresën nr.*** prot., datë 17.7.2017 ka konfirmuar automjet me targa TR *** U, në pronësi të bashkëshortit të subjektit Q.Z dhe ka dërguar faturën tatimore të plotësuar me nr.***, e cila mban datën 26.06.2010, pra dy ditë para lidhjes së kontratës së shitblerjes.

1.4 Në lidhje me këtë konstatim bashkëshorti i subjektit në përgjigje të pyetësorit të parë ka sqaruar se: *Data e saktë e blerjes së automjetit është data 26.06.2010, pasi kjo është data kur është kryer pagesa, (paguar çmimin e blerjes). Pagesa është kryer cash.*

1.5 Bashkëshorti i subjektit për të vërtetuar deklaratimet e tij ka paraqitur deklaratë datë 28.09.2020 të shoqërisë “****” sh.p.k, e cila deklaron se data e saktë e shitjes së automjetit është data 26.06.2010, ndërsa te kontrata e shitjes është bërë një lapsus në datën e përpilimit të kontratës, pasi duhet të ishte data 26.06.2010.

1.6 Bazuar në deklaratën doganore⁶ të datës 6.5.2010, rezulton se ky automjet është blerë në vlerën prej 6,132 euro dhe është paguar edhe detyrimi doganor në vlerën prej 177,047 lekë. Në datën 26.6.2010 ky automjet i është shitur subjektit dhe bashkëshortit në vlerën prej 8.575 euro. Pra çmimi i blerjes nga subjekti rezultoi se është më i madh se çmimi i blerë nga pala shitëse shoqëria “****” sh.p.k.

1.7 Komisioni bazuar në deklaratimet e subjektit, lidhur me burimin e të ardhurave, ka kryer analizën financiare për blerjen e këtij automjeti në tabelën në vijim.

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit tip “Peugeot”, datë 26.6.2010

Pershkrimi	Vlera
Te ardhura nga paga Vjosa Zaimi 01.01.10 - 26.06.10	453,938
Te ardhura nga paga Q. Z. 01.01.10 - 26.06.10	735,088
Te ardhura totale 01.01.10 - 26.06.10	1,189,026
Shpenzime jetese 01.01.10 - 26.06.10	200,376
Shpenzime qiraje 01.01.10 - 26.06.10	120,000
Shpenzime shkollimi femijet 01.01.10 - 26.06.10	9,000
Shpenzime mobilimi 01.01.10 - 26.06.10	12,500
Shpenzime totale 01.01.10 - 26.06.10	341,876
Blerje automjeti Peugeot dt. 26.06.10	1,172,830
Ndryshim likuiditeti 31.12.09 - 26.06.10	-89,472
Pamundesi kursimi	-236,208

³ Praktika bashkëlidhur deklaratës: (i) Kontratë nr.***, datë 28.6.2010; (ii) Faturë tatimore shitje vulosur nga “****” sh.p.k Tirana; (iii) Çertifikatë e pronësisë së mjetit rrugor me targa TR *** U.

⁴ Deklaruar në DVP-në e vitit 2010

⁵ Bazuar në deklaratën doganore import *** rezulton se vlera e automjetit ka qenë 6.132 euro (843,947.16 lekë) dhe janë paguar detyrime tatimore në shumën 177,185 lekë.

⁶ Shiko përgjigjen e DPSHTRR me nr.*** datë 30.6.2020

1.8 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit dhe për mbulimin e shpenzimeve të periudhës në shumën -236,208 lekë.

1.9 Në përfundim të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të provuar të kundërtën e këtij rezultati, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

1.10 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi se:

Nga Komisioni në vendimin nr.321 dt.10.12.2020 në lidhje me automjetin është konstatuar se: “Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme në shumën 236,337 lekë për të paguar blerjen e automjetit.

Por në përfundim të gjykimit Komisioni ka konkluduar se: Subjekti rezulton me një bilanc negativ në momentin e blerjes së automjetit të tij, në qershor të vitit 2010, në shumën 236.337 lekë, shumë e cila në vlerësim të Komisionit, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke e vënë në balancë vlerën e tyre në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se kjo mungesë të ardhurash në këtë moment, nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qënë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikën 1 dhe 3 të nenit 61”.

Meqënëse për pasurinë automjet, si nga Komisioni në vendimin nr. 321, datë 10.12.2020, ashtu edhe në Rezultatet e hetimit nga ky Komision, është arritur i njëjti përfundim, kërkoj që të vlerësohet në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe të parimit të barazisë përpara ligjit.

Vlerësim i Komisionit

1.11 Pretendimi i subjektit se: “*Meqënëse për pasurinë automjet, si nga Komisioni në vendimin nr. 321, datë 10.12.2020, ashtu edhe në rezultatet e hetimit nga ky Komision, është arritur i njëjti përfundim, kërkoj që të vlerësohet në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe të parimit të barazisë përpara ligjit*”, nuk qëndron. Trupi gjykues vlerëson se nuk jemi përpara zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar (res judicata), për sa arsyetohet në vijim:

(i) Ligji nr.76/2016, Kushtetua e Republikës së Shqipërisë, parashikon se subjektet e rivlerësimit janë...*Pika 3 “Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio. Pika 5 “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese”. Pika 6 “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë të pavarur dhe të paanshëm.*

(ii) Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, rivlerësimi i bashkëshortit të subjektit, është kryer nga një trup gjykues i pavarur e Komisionit, dhe po ashtu nga një trupë tjetër e shortuar dhe e pavaruar për subjektin e rivlerësimit. Në këtë kontekst, parashikimet ligjore të ligjit nr.84/2016, për kryerjen e këtij procesi e lidhin çështjen e rivlerësimit për çdo subjekt, dhe ligjvënësi⁷ për këtë ka parashikuar dispozitat përkatëse ligjore të cilat veprojnë individualisht ndaj secilit prej tyre. Vendimi nr. 321, datë 10.12.2020 i një trupi tjetër gjykues të Komisionit , është dhënë vetëm për bashkëshortitn e subjektit dhe subjekti i rivlerësimit është bërë pjesë e këtij procesi vetëm në rrethanat ligjore të parashikuara nga ky ligj, ku subjekti i rivlerësimit ka pasur statusin e personit të lidhur, çka do të thotë se subjekti nuk është palë për të cilën trupi tjetër gjykues i Komisionit është shprehur me një vendimarrje për të, por ka qënë pjesë e procesit, sipas parashikimeve te ligjit Nr.84/2016.

⁷ Neni 48, Bashkëpunimi gjatë procesit të hetimit “Subjekti i rivlerësimit bashkëpunon me Komisionin dhe Kolegjin e Apelit, të cilët, në marrjen e vendimit, mbajnë parasysht gadishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit. Neni 49 Mjetet për kërkimin e provës 1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelit ka të drejtë: a) të marrë dokumente ligjore në kuptim të nenit 3, pika 2, të këtij ligji; b) të mbledhë deklarata nga subjekti i rivlerësimit.

(iii) Në respektim të parimeve të paanësisë, Komisioni ka kryer nje hetim dhe vlerësim të pavaruar për subjektin e rivlerësimit edhe pse ka vendosur të administrojë provat nga dosja hetimore e procesit të rivlerësimit të bashkëshortit. Ky është një ndër argumentet bazë nga të cilët paraprihet trupi gjykues në hetimin e kryer, ndërsa pretendimi i subjektit se ndodhemi përpara gjësë së gjykuar përse i përket kriterit të pasurisë do të përbente paragjykim për hetimin.

(iv) Standardi i gjësë së gjykuar i lidhur me veprimin e ndërmarrë, pra me vendimarrjen ndaj bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ndikon drejtëpërdrejtë në palën ndaj të cilës vendimi është marrë, pra ndaj bashkëshortit të saj. Për rrjedhojë vendimarrja e një trupi tjetër gjykues të Komisionit, edhe pse ka marrë formë të prerë nuk ekzekutohet ndaj subjektit të rivlerësimit dhe për pasojë edhe parimi i gjësë së gjykuar nuk gjen vend në rastin e procesit të rivlerësimit për subjektin Vjosa Zaimi.

1.12 Në lidhje me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës mbi balancën negative të rezultuar në qershor 2010, në momentin e blerjes së automjetit. Për këtë arsye subjekti i rivlerësimit rezulton me një bilanc negativ në shumën 236,337 lekë, në momentin e blerjes së automjetit.

1.13 Pavarësisht kësaj balance negative, në vlerësim të Komisionit, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke e vënë në balancë vlerën e tyre në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se kjo mungesë të ardhurash në këtë moment, nuk mund të shërbejë e vetme si shkak për masë disiplinore të shkarkimit nga detyra.

2. Apartament banimi, me sip.98.3 m², Tiranë.

2.1 Subjekti ka deklaruar pasurinë apartament me sip. 98.3 m², me nr. pasurie ***, z. k. 8150 , ndodhur në sheshin “****”, Rruga “****” pall. ***, shk. ***, k. ***, ap. *** Tiranë⁸. Blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** Rep., *** Kol., datë 16.12.2013. Vlera 12,460,000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

2.2 Burimi i krijimit është deklaruar: Me të ardhurat e kursyera nga paga e subjektit dhe bashkëshortit të saj në vitet e punës në shumën 7,500,000 lekë, të ardhurat nga interesi i bonove të Thesarit në shumën 300,000 lekë, si dhe kontratat e kredisë bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.2.2014 e marrë në Bankën Societe Generale Albania në shumën 4,700,000 lekë.

2.3 ILDKPKI për këtë pasuri ka konstatuar: *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar të shtetasit F.H, i cili i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 4,700,000 lekë.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

2.4 Rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti i saj me kontratë shitblerje nr.*** Kol., datë 16.12.2013, ka blerë nga shtetësja N.I, pasurinë apartament me sip. 98.3m² ndodhur në Tiranë, me nr.pasurie ***, ZK.***. Çmimi i shitjes është 12,460,000 lekë (ose e konvertuar në vlerën 89.000 euro).

2.5 Bazuar në nenin 2 të kontratës së shitblerjes, pagesa do të bëhej si vijon: (i) shuma 10,560,000 lekë (e konvertuar 75.430 euro) do të likuidohet brenda datës 20.12.2013; (ii) deri në datën 30.12.2013 do të likuidohet shuma 1,000,000 lekë (konvertuar në 7.143 euro); deri në datën 15.1.2014 do të likuidohet shuma prej 900,000 lekë (konvertuar 6,427 euro).

⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) *Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme “Apartament banimi” nr.*** Rep, *** Kol, datë 16.12.2013;* (ii) *Çertifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 27.1.2014;* (iii) *Deklaratë noteriale nr.*** Rep, nr.*** Kol, datë 15.1.2014* (iv) *Tirana Bank, nxjerrje llogarie e llogarisë në euro në emër të Q.Z;* (v) *Deklaratë noteriale, nr. *** Rep, nr. *** Kol, datë 6.1.2014;* (vi) *2 ekstrakte historike të personit fizik F.H së bashku me certifikatat e regjistrimit për secilin NIPT;* (vii) *Kontratë kredie bankare afatgjatë për shtëpi, nr. *** rep, nr. *** kol, datë 4.2.2014;* (viii) *Kontratë hipotekimi nr. *** Rep, nr. *** Kol, datë 24.2.2014*

2.6 Subjekti ka depozituar pranë Komisionit deklaratë noteriale me nr.*** datë 15.1.2014, të palës shitëse, e cila deklaroi se blerësi (subjekti dhe bashkëshorti) ka shlyer të gjitha detyrimet për shitblerjen e apartamentit.

2.7 Si burim për blerjen e këtij apartamenti në DVP/2013, subjekti ka deklaruar:

- a. Të ardhurat në lekë të investuar në vitet paraardhëse në bono, në shumën 6,900,000 lekë;
- b. të ardhurat e kursyera nga paga gjatë vitit 2013 në shumën 900,000 lekë; si dhe
- c. hua në shumën 4,700,000 lekë.

2.8 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit në bankën BKT, “Raiffeisen Bank” dhe “Credins Bank” rezulton se janë kryer këto tërheqje:

- në datën 19.12.2013, shuma 4,200,000 lekë, nga banka BKT, pas maturimit të bonove thesarit në shumën 3,700,000 lekë dhe 510,000 lekë;
- në datën 19.12.2013, shuma 500,000 lekë, nga llogaria e pagës së subjektit në “Raiffeisen Bank”;
- në datën 19.12.2013, shuma 774,300 lekë, nga “Credins Bank”, maturimi i bonove të thesarit të investuara qysh në 29.09.2009, si kursime nga paga e subjektit dhe tërheqje në “Raiffeisen Bank”.
- në datën 20.12.2013, shuma 418,500 lekë, nga llogaria e pagës së subjektit në “Raiffeisen Bank”;
- në datën 30.12.2013, shuma 1,000,000 lekë, nga banka BKT pas maturimit të bonove të thesarit;
- në datën 14.01.2014, shuma 900,000 lekë, nga banka BKT, pas maturimit të bonove të thesarit.

Në total, rezultoi se është tërhequr shuma 6,892,800 lekë për vitin 2013 dhe 900,000 lekë për vitin 2014, të cilat kanë shërbyer për kryerjen e pagesave të apartamentit.

2.9 Bazuar në shkresën e ILDKPKI-së nr.*** prot., datë 14.09.2020 rezulton se pagesat për këtë apartament janë bërë nga subjekti në llogarinë e shitëses në “Intesa San Paolo Bank” si vijon:

- në datë 19.12.2013, subjekti ka depozituar shumën 42.000 euro;
- në datë 20.12.2013, subjekti ka depozituar shumën 33.500 euro;
- në datë 31.12.2013, subjekti ka depozituar shumën 7.000 euro;
- në datë 14.01.2014, subjekti ka depozituar shumën 6.500 euro;

Huamarrje nga F.H

2.10 Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Tirana Bank”, rezulton se në datë 19.12.2013 është transferuar shuma 33.500 euro nga shtetasi F.H, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit. Kjo shumë është tërhequr nga bashkëshorti i subjektit në datë 20.12.2013.

2.11 Në lidhje me shumën 33.500 euro, nga subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratën “*Vetting*” është depozituar deklaratë noteriale, nr. ***, datë 6.1.2014, nëpërmjet së cilës shtetasi F. H deklaroi se: “*Me qëllim blerjen e banesës, në datën 19.12.2013, i ka dhënë në formë huaje pa interes të afërmve të tij shtetasve Q dhe Vjosa Zaimi në shumën 33,500 euro e barasvlefshme me 4,700,000 lekë. Këtë shumë e ka pasur të depozituar në ‘Tirana Bank’ dhe deklaruesit Q dhe Vjosa Zaimi do t’ia shlyejnë këtë hua me marrjen e kredisë bankare prej tyre*”.

2.12 Shlyerja e huas vërtetohet me nxjerrjen e llogarisë së subjektit dhe bashkëshortit të saj në “OTP Bank” nga ku rezulton se në datë 03.03.2014⁹ është transferuar shuma 4,664,000 lekë në llogarinë e shtetasit F.H.

2.13 Nga ana e subjektit nuk rezulton që ai të ketë deklaruar si burim në deklaratën *Vetting* huanë e marrë nga z. H për blerjen e këtij apartamenti, por ndërkohë tek seksioni detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë subjekti ka deklaruar: “*Hua afatshkurtër dhe pa interes e marrë nga shtetësi F.M.H (burri i vajzës së hallës të bashkëshortit, Sh.H), me qëllim pagimin e këstit të blerjes së apartamentit në shumën 33.500 Euro, (ose 4,700,000 lekë), në datën 19.12.2013 nga banka “Tirana” dhe e shlyer plotësisht me marrjen e kredisë bankare në bankën “Societe Generale Albania” sh.a. në datën 3.3.2014 e pasqyruar me deklaratën noteriale nr.*** Rep. nr.*** Kol, datë 6.1.2014, përpiluar në Dhomën e Noterisë Tiranë.*”

2.14 Komisioni ka hetuar në lidhje me aftësitë huadhënëse të zotit H.

Në lidhje me z. H nga hetimi ka rezultuar se:

- a) Është i regjistruar si person fizik me NIPT *** me objekt shërbime në ndërtim. Në lidhje me këtë aktivitet nga ana e DRT Tiranë¹⁰ informohemi se xhiro dhe fitimi i realizuar për periudhën deri në dhënien e huasë është si më poshtë:

Viti	Qarkullimi	Fitimi pas tatimit
2011	7,233,194	4,099,612
2012	6,598,498	4,008,014
2013	0	0

Për vitin ushtrimor 2013, (vit të cilin pretendohet dhënia e huasë në shumën 4.700.000 lekë) rezultoi se qarkullimi dhe fitimi nga aktiviteti i z.F.H ka qënë 0 (zero) lekë.

Subjekti fizik nuk ndan dividend, pasi bazuar në nenin 5.6 “vendimi për destinimin e fitimit” të UMF-së nr. ***, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, subjekti nuk ka detyrim të depozitohet pranë administratës tatimore vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë, lidhur me rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit pas tatimit, pasi është person fizik.

b) Është i regjistruar si person fizik me NIPT *** me objekt Bar kafe. Statusi çregjistruar. DRT Tiranë informon se shtetasi F.M.H i dtl. 8.4.1955 është i regjistruar me NIPT *** me aktivitet “Bar kafe” me përgjegjësinë tatimore biznes i vogël, regjistruar në QKR datë 28.09.2011 dhe ka aplikuar për mbyllje të aktivitetit në datë 29.12.2017. Të ardhurat e deklaruara ndër vite, për këtë nipt për periudhën deri në dhënien e huasë, janë si vijon: (i) për vitet 2011 dhe 2012 nuk ka plotësuar pasqyrë të ardhura dhe shpenzime; si dhe (ii) për vitin 2013 subjekti ka deklaruar të ardhura 0 (zero) lekë, shpenzime 0 (zero) lekë.

Analiza financiare

2.15 Sa i takon mundësisë së z. F.H, për të dhënë hua shumën 33,500 euro, në datën 19.12.2013, është bërë analiza financiare, e cila është pasqyruar në tabelën vijuese.

⁹ Kredia është disbursuar në datë 26.02.2014, në shumën 4,700,000 lekë.

¹⁰ Shih shkresë nr. *** prot., datë 20.08.2020 dhe nr. *** prot., datë 02.08.2017 (administruar nga ILDKPKI) të DRT Tiranë,

Analizë e mundësisë për huadhënien e shumës 33.500 euro, nga z. F.H - 2013

Pershkrimi	Vlera
Të ardhura nga biznesi F.H, për periudhën 2011 - 2013	8,107,626
Shpenzime jetese për periudhën 2011 – 2013	417,192
Dhënë hua Q.Z në vitin 2013	4,700,000
Mundesi kursimi	2,990,434

Në përfundim rezultoi se huadhënësi F.H, ka patur mundësi financiare për t'i dhënë hua bashkëshortit të subjektit vlerën 33,500 euro me datë 19.12.2013.

Kredia bankare në vlerën 4,700,000 lekë, në “Societe General Albania”, në vitin 2014

- 2.16** Në datë 4.2.2014 me Kontratë kredie bankare¹¹ afatgjatë për shtëpi, nr. ***, subjekti dhe bashkëshorti kanë marrë kredi në shumën 4,700,000 lekë me afat 96 muaj. Në kontratën e kredisë në nenin B/2 është përcaktuar se kredia do të kalojë me transfertë në llogarinë e z. F.H për likuidim detyrimi.
- 2.17** Sipas kontratës së kredisë qëllimi i marrjes së saj është “Kredia do të përdoret nga Kredimarrësi për blerje apartamenti”, ndërkohë që rezultoi se apartamenti është përfituar (është paguar i gjithë detyrimi financiar ndaj palës shitëse) nga subjekti dhe bashkëshorti para marrjes së kredisë.
- 2.18** Për më tepër pasuria e përfituar (apartament me sip. 98.3 m2) është regjistruar pranë ZVRPP-në Tiranë në emër të subjektit dhe bashkëshortit dhe është vendosur hipoteka mbi këtë pasuri si garanci për shlyerjen e kredisë.
- 2.19** Pra përfitimi i kredisë nga banka nuk është për blerje apartamenti por për shlyerje huaje ndaj shtetasit F.H.
- 2.20** Bazuar në deklaratën noteriale nr. *** datë 6.2.2020 vërtetohet se subjekti dhe bashkëshorti i saj ka shlyer plotësisht kredinë ndaj “OTP Bank”.

Investim në bono thesari tek Banka e Shqipërisë

- 2.21** Nga të dhënat e Bankës së Shqipërisë rezulton se bashkëshorti i subjektit ka blerë bono thesari si vijon:

Data e zhvillimit të ankandit	Data e emetimit të bonove	Afati	Vlera nominale	Çmimi blerjes
20.11.2007	22.11.2007	1-vjeçar	2,100,000	1,943,965
20.05.2008	22.05.2008	6-mujor	900,000	867,652
02.12.2008	04.12.2008	1 vjeçar	3,700,000	3,412,088
02.12.2009	03.12.2009	1-vjeçar	3,700,000	3,388,329

¹¹ Shlyerja e kredisë është siguruar me Kontratë hipotekimi nr. *** , datë 24.2.2014 nëpërmjet së cilës është vënë në hipotekë apartamenti në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit.

15.12.2009	17.12.2009	1-vjeçar	300,000	274,947
30.11.2010	02.12.2010	1-vjeçar	3,700,000	3,448,702
14.12.2010	16.12.2010	1-vjeçar	510,000	476,479
25.11.2011	01.12.2011	1-vjeçar	3,700,000	3,453,380
13.12.2011	15.12.2011	1-vjeçar	510,000	476,938
27.12.2011	29.12.2011	1-vjeçar	1,000,000	937,106
27.11.2012	30.11.2012	1-vjeçar	3,700,000	3,480,187
11.12.2012	13.12.2012	1-vjeçar	510,000	479,484
24.12.2012	27.12.2012	1-vjeçar	1,000,000	940,437
08.01.2013	10.01.2013	1-vjeçar	900,000	844,414

**Interesat e Bonove të Thesarit, para-paguhen*

Shumat e bonove të thesarit janë disbursuar në llogarinë e subjektit pranë BKT si më poshtë:

- në datën 09.12.2013, shuma 3,700,000 lekë;
- në datën 12.12.2013, shuma 510,000 lekë;
- në datën 19.12.2013, është tërhequr cash shuma 4,200,000 lekë;
- në datën 26.12.2013, shuma 1,000,000 lekë, e cila është tërhequr në datë 30.12.2013; si dhe
- në datën 09.01.2014, shuma 900,000 lekë, e cila është tërhequr në datë 14.01.2014

2.22 Subjekti ka blerë bono thesari si vijon:

Data e zhvillimit të ankandit	Data e emetimit të bonove	Afati	Vlera nominale	Çmimi blerjes
29.09.2009	1.10.2009	1-vjeçar	800,000	731,409
28.09.2010	30.09.2010	1-vjeçar	800,000	742,699
27.09.2011	29.09.2011	1 vjeçar	800,000	743,165
09.10.2012	11.10.2012	1-vjeçar	800,000	749,322
08.10.2013	10.10.2013	1-vjeçar	800,000	770,443

2.23 Bazuar në dokumentin e Bankës së Shqipërisë “vërtetim mbi shpalljen fitues”, nga ku rezulton se, subjekti ka patur bono në vlerë nominale 500,000 lekë dhe çmim blerje 458,237 lekë emetuar në datë 29.09.2005 dhe maturim 28.09.2006.

2.24 Është analizuar mundësia e subjektit për krijimin e investimit prej 500,000 lekë në bono thesari si vijon:

**Analiza e mundësisë së blerjes së bonove të thesarit në shumën 500,000 leke, shtetases
Vjosa Cela, në datën 29.09.2005**

Pershkrimi	Vlera
Të ardhura nga paga 2000 - 29.09.05 Vjosa Cela	2,719,804
Shpenzime jetese 3 persona 2000 - 29.09.05	1,718,675
Shpenzime qiraje 2000 - 29.09.05	145,500
Blere Bono thesari dt. 29.09.05	500,000
Mundësi kursimi	355,629

2.25 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtyre bonove të thesarit me datë 29.09.2005.

2.26 Janë analizuar investimet në bono thesari të bëra nga subjekti dhe bashkëshorti i saj ndër vite. Janë analizuar burimet e krijimit të atyre investimeve të cilat janë investime të reja ose të shtuara dhe jo ato të cilat rinvestohen kohë pas kohe.

2.27 Është analizuar investimi i bërë në bono thesari në vlerën 2,100,000 lekë me datë 20.11.2007. Ky investim buron nga një transfertë për blerje bono thesari nga llogaria e bashkëshortit të subjektit me datë 12.11.2007 në vlerën 2,103,500 lekë. Kjo gjendje e transferuar krijohet nga: (i) të ardhura nga paga e bashkëshortit të subjektit në vlerën 1,103,500 lekë; (ii) vlera 500,000 lekë e ardhur nga llogaria e subjektit me datë 05.11.2007; (iii) një depozitim në vlerën 500,000 lekë me datë 02.05.2007 të bërë nga bashkëshorti i subjektit.

2.28 Në procesverbalin e ILDKPKI të datës 11.02.2015, ku subjekti dhe bashkëshorti janë pyetur lidhur me burimin e bonove të thesarit të deklaruar në DPV 2007, bashkëshorti deklaroi: *“Kjo shumë përbëhet nga shuma 500,000 lekë e depozituar nga bashkëshortja në vitin 2005, si kursime të saj 100% pasi ka qënë beqare, 600,000 lekë si kursime të përbashkëta nga të dy si deklarues të deklaruar si cash dhe 1 milion lekë të krjuara në vitin 2007 nga të ardhurat nga pagat vjetore. Kam deklaruar shumën 1,000,000 lekë pranë Bankës së Shqipërisë dhe 1,000,000 lekë bashkëshortja që në total përbëjnë vlerën e konfirmuar nga banka.”*

2.29 Bazuar në deklaratat periodike 2003 – 2007, as subjekti dhe as bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar kursime cash. Meqë në DPV 2006, nuk janë deklaruar kursime cash, vlera e derdhjes prej 500,000 lekë me datë 2.5.2007, nuk mund të ketë si burim kursimet cash të vitit 2006.

2.30 Është analizuar mundësia e derdhjes së vlerës **500,000 lekë** nga bashkëshorti në datë 2.5.2007.

2.31 Nga analiza financiare, nuk vërtetohet burimi i ligjshëm i derdhjes së vlerës 500,000 lekë në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, vlerë kjo që do shërbejë për investimin në bono thesari me vlerën 2,100,000 lekë. Nga kjo analizë dukej se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për shtimin e likuiditeteve dhe përballimin e shpenzimeve të periudhës në shumën prej -425,082 lekë.

2.32 Është analizuar mundësia e investimit në bono thesari në vlerën **900,000 lekë** me datë 13.05.2008. Nga kjo analizë dukej se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin burime të

ligjshme të mjaftueshme për shtimin e likuiditeteve dhe përballimin e shpenzimeve të periudhës në shumën prej -207,671 lekë.

- 2.33** Është analizuar mundësia e investimit në bono thesari nga bashkëshorti i subjektit në vlerën **720,000 lekë** në datën 25.11.2008.

Analiza e mundësisë së investimit në shumën 720,000 lekë në bono thesari, datë 25.11.2008

Te ardhura nga paga Vjosa Zaimi 13.05.08 - 25.11.08	394,878
Te ardhura nga paga Q.Z. 13.05.08 - 25.11.08	766,251
Te ardhura totale 13.05.08 - 25.11.08	1,161,129
Shpezime jetese 13.05.08 - 25.11.08	204,930
Shpenzime arredimi 13.05.08 - 25.11.08	12,500
Shpenzime transport i brendshem 13.05.08 - 25.11.08	8,000
Shpenzime qiraje 13.05.08 - 25.11.08	120,000
Shpenzime totale 13.05.08 - 25.11.08	345,430
Ndryshim likuiditeti 13.05.08 - 25.11.08	662,928
Mundesi kursimi	152,771

- 2.34** Nga kjo analizë rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për shtimin e likuiditeteve dhe përballimin e shpenzimeve të periudhës.

- 2.35** Në analizën financiare shpenzimet e jetesës së vitit 2008 janë më të larta se standarti i përdorur zakonisht nga Komisioni sepse bashkëshorti i subjektit ka deklaruar në DPV 2008 që të ardhurat nga paga e bashkëshortes dhe të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit të përfituara në muajt maj dhe dhjetor të vitit 2008 janë të shpenzuara. Prandaj nga totali i këtyre të ardhurave, janë zbritur shpenzimet e tjera të realizuara në vitin 2008 dhe diferenca është shtuar tek shpenzimet e jetesës.

- 2.36** Është analizuar mundësia e investimit në bono thesari nga subjekti në vlerën 800,000 lekë në datën 28.09.2009.

Analiza e mundësisë së investimit 800,000 lekë në bono thesari në datën 28.09.2009

Te ardhura nga paga Vjosa Zaimi, 01.01.09 - 28.09.09	637,290
Te ardhura nga paga Q.Z, 01.01.09 - 28.09.09	1,021,703
Te ardhura totale 01.01.09 - 28.09.09	1,658,993
Shpezime jetese, 01.01.09 - 28.09.09	307,395
Shpenzime arredimi, 01.01.09 - 28.09.09	18,750
Shpenzime transport i brendshem, 01.01.09 - 28.09.09	36,000
Shpenzime arsimimi i femijeve, 01.01.09 - 28.09.09	13,500
Shpenzime qiraje, 01.01.09 - 28.09.09	180,000
Shpenzime totale 01.01.09 - 28.09.09	555,645
Ndryshim likuiditeti, 31.12.08 - 28.09.09	769,850
Mundesi kursimi	333,498

- 2.37** Nga kjo analizë rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për shtimin e likuiditeteve dhe përballimin e shpenzimeve të periudhës.

2.38 Është analizuar mundësia e investimit në bono thesari nga subjekti në vlerën **300,000 lekë** në datën 08.12.2009.

Analiza e mundësisë së investimit në shumën 300,000 lekë në bono thesari, në datën 08.12.2009

Te ardhura nga paga Vjosa Zaimi, 28.09.09 - 08.12.09	201,807
Te ardhura nga paga Q.Z, 28.09.09 - 08.12.09	255,006
Te ardhura nga bono thesari, 28.09.09 - 08.12.09	340,236
Te ardhura totale 28.09.09 - 08.12.09	797,049
Shpezime jetese, 28.09.09 - 08.12.09	85,388
Shpenzime arredimi, 28.09.09 - 08.12.09	5,208
Shpenzime transport i brendshem, 28.09.09 - 08.12.09	10,000
Shpenzime arsimimi i femijeve, 28.09.09 - 08.12.09	3,750
Shpenzime qiraje, 28.09.09 - 08.12.09	60,000
Shpenzime totale 28.09.09 - 08.12.09	164,346
Ndryshim likuiditeti, 28.09.09	268,801
Mundesi kursimi	363,902

2.39 Nga kjo analizë rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për shtimin e likuiditeteve dhe përballimin e shpenzimeve të periudhës.

2.40 Është analizuar mundësia e investimit në bono thesari nga bashkëshorti i subjektit në vlerën 510,000 lekë në datën 16.12.2010. Konstatohet se për krijimin e këtij investimi kanë shërbyer: (i) gjendja 300,000 lekë nga investimi i mëparshëm në bono thesari, vlerë e cila po riinvestohet; (ii) të ardhurat e interesit nga bonot e thesarit të përfituara nga ankandi i datës 02.12.10, (ku riinvestohet vlera prej 3,700,000 lekë nga bashkëshorti i subjektit).Të dyja këto burime janë të ligjshme duke vërtetuar kështu burimin e ligjshëm të investimit prej 510,000 lekë në datën 16.12.2010.

2.41 Është analizuar mundësia e investimit në bono thesari nga bashkëshorti i subjektit në vlerën 1,000,000 lekë në datën 21.12.2011.

2.42 Konstatohet nga statement bankar i llogarisë së pagës së bashkëshortit të subjektit, se ky investim bëhet përmes transfertës me përshkrim “Kalim bono thesari” në vlerën 1,000,300 lekë. Pra vërtetohet që burimi i investimit është me të ardhura të ligjshme nga punësimi i bashkëshortit të subjektit.

2.43 Për pagesën e apartamentit janë bërë tërheqjet nga llogaritë e bashkëshortit të subjektit sipas pikës 2.8 të këtij relacioni. Gjithashtu, në pikën 2.9 dhe 2.10 të relacionit, sqarohen pagesat që janë bërë nga bashkëshorti i subjektit për blerjen e apartamentit përmes derdhjeve në llogarinë pranë Intesa Sanpaolo Bank në emër të N dhe E.I.

2.44 Vlera prej 4,200,000 lekë, e cila ka shërbyer për blerjen e apartamentit, është tërhequr me datë 19.12.2013. Kjo vlerë përbëhet nga disa derdhje të bëra në vite pranë Bankës së Shqipërisë për investim në bono thesari. Konkretisht:

- vlera 2,100,000 lekë kaluar në llogari të Bankës së Shqipërisë, me datë 15.11.07 (konkretisht në vlerën 500,000 lekë si pjesë përbërëse e saj)

- vlera 900,000 lekë kaluar në llogari të Bankës së Shqipërisë, me datë 13.05.08
- vlera 720,000 lekë kaluar në llogari të Bankës së Shqipërisë, me datë 25.11.09
- vlera 300,000 lekë kaluar në llogari të Bankës së Shqipërisë, me datë 08.12.09
- vlera 210,000 lekë kaluar në llogari të Bankës së Shqipërisë, me datë 07.12.10

2.45 Nga këto vlera, nga analiza e mësipërme financiare, nuk u vërtetua burimi i investimit të vlerave 900,000 lekë në datën 13.05.08 dhe as burimi i investimit në vlerën 500,000 lekë në vlerën 15.11.07. Si rrjedhim, vlerat 900,000 lekë dhe 500,000 lekë nuk u përfshinë në vlerën totale të burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit.

2.46 Nga analiza financiare dukej se subjekti dhe bashkëshorti nuk kishin mjaftueshëm burime të ligjshme për blerjen e apartamentit me një pamundësi prej 7,534€ (-1,142,960 lekë)

2.47 Në përfundim të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit lidhur me:

- Subjekti nuk ka deklaruar gjëndje cash në DPV për vitin 2006, si burim i pretenduar për shlyrje detyrimi në vitin 2007. Për këtë arsye në analizë financiare për këtë pasuri, nuk janë përfshirë të ardhura cash të pretenduara nga viti 2006.
- Subjekti nuk ka patur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie pasi rezultoi në pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për depozitim në vlerën 500,000 lekë në datën 2.5.2007 dhe për depozitim në vlerën 900,000 lekë në datën 13.5.2008. Kjo ka çuar në një pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për pagesën e apartamentit në vlerën (-1,142,960 Lekë).

2.48 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti deklaroi se: 1. Kërkoj që shuma prej 500.000 lekë të vlerësohet dhe të përfshihet edhe nga ky trup gjykues, si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit të banimit, duke u mbajtur i njëjti standart vlerësimi, në respektim të parimit të barazisë përpara ligjit.

Së pari: Në DVP/2006 nuk është deklaruar gjendje cash, por në DVP/2007 janë deklaruar të ardhura të kursyera nga paga e shpërblime mbi pagën gjatë vitit 2006 – 2007, të cilat në vitin 2007 ndodheshin në llogarinë rrjedhëse në emër të bashkëshortit në “Raiffeisen Bank”.

Së dyti: Gjithashtu për këtë shumë kam dhënë shpjegime me procesverbalin e datës 11.02.2015, pranë ILDKPKI, të cilës i është referuar edhe Komisioni në Rezultatet e Hetimit.

Sa më sipër, nga ana jonë kjo shumë është deklaruar dy herë përpara organit kompetent, ILDKPKI, prandaj duhen konsideruar si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr.84/2016. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe Komisioni i Posacëm i Apelimit në jurisprudencën e tij¹².

Së treti: Në analizën financiare të kryer nga ky Trup Gjykues për vitin 2006, sipas tabelës bashkëngjitur këtij akti, rezulton se në vitin 2006, kam pasur mundësi kursimi në vlerën 1.099.250 lekë, e cila është e mjaftueshme për krijimin e shumës 600.000 lekë kursime cash. Së katërti: Shuma prej 500.000 lekë, është vlerësuar dhe përfshirë si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit të banimit, nga Komisioni në vendimin nr. 321, datë 10.12.2020.

¹² Shiko vendimit e KPA nr. 25 dt.29.07.2021 dhe nr. 27 dt.21.09.2021

2. Nuk jam dakort me Rezultatet e Hetimit lidhur me mospërfshirjen e shumës 900.000 lekë si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit për arsyet e mëposhtme;

Së pari: Në analizën financiare të pasqyruar në Rezultatet e Hetimit, nuk rezulton të jetë përfshirë edhe shuma prej 370.377.58 lekë, e ndodhur në llogarinë rrjedhëse në emër të bashkëshortit pranë "Raiffeisen Bank". Kjo shumë është deklaruar në DVP/2008, si kursim për vitin 2007.

Në datë 09.05.2008, është tërhequr shuma prej 800.000 lekë, e cila në datën 13.05.2008, është investuar në Bono Thesari.

Së dyti: Në analizën financiare të pasqyruar në Rezultatet e Hetimit, nxirret diferenca prej 207.671 lekë, si pamundësi kursimi, ndërsa në analizën financiare përfundimtare, në vlerën totale të burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit, nuk zbritet diferenca e konstatuar si pamundësi kursimi, por zbritet e gjithë shuma prej 900.000 lekë.

Komisioni duhet të zbriste, vetëm diferencën e konstatuar si pamundësi kursimi, vlerën prej 207.671 lekë. Megjithatë, edhe diferenca e konstatuar nga Komisioni, është e papërfillshme dhe duhet të vlerësohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Së treti: Shuma prej 900.000 lekë, është vlerësuar dhe është përfshirë si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit të banimit, nga ana e Komisionit në vendimin nr. 321, datë 10.12.2020. Kërkoj që shuma prej 900.00 lekë të vlerësohet dhe të përfshihet edhe nga ky trup gjykues, si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit të banimit, duke u mbajtur i njëjti standart vlerësimi, në respektim të parimit të barazisë përpara ligjit.

Vlerësimi i Komisionit

2.49 Në lidhje me pretendimin e subjektit se: (i) *Shuma prej 500,000 lekë, është vlerësuar dhe përfshirë si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit të banimit, nga Komisioni në vendimin nr. 321, datë 10.12.2020 dhe (ii) Shuma prej 900,000 lekë, është vlerësuar dhe është përfshirë si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit të banimit, nga ana e Komisionit në vendimin nr. 321, datë 10.12.2020, trupi gjykues vlen të theksojë dhe njëherë se ky pretendim nuk qëndron, pasi standardi i gjësë së gjykuar i lidhur me veprimin e ndërmarrë, pra me vendimmarrjen ndaj bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ndikon drejtpërdrejtë në palën ndaj të cilës vendimi është marrë, pra ndaj bashkëshortit të saj. Për rrjedhojë vendimmarrja e një trupi tjetër gjykues të Komisionit, edhe pse ka marrë formë të prerë nuk zbatohet ndaj subjektit të rivlerësimit dhe për pasojë edhe parimi i gjësë së gjykuar nuk gjen vend në rastin e procesit të rivlerësimit për subjektin Vjosa Zaimi. Për më tepër referoj arsyetimit tek pasuria nr. 1, në lidhje me zbatimin e gjësë së gjykuar.*

2.50 Në lidhje me pretendimin e subjektit se [...] *Në DVP/2006 nuk është deklaruar gjendje cash, por në DVP/2007 janë deklaruar të ardhura të kursyera nga paga e shpërblime mbi pagën gjatë vitit 2006 – 2007, të cilat në vitin 2007 ndodheshin në llogarinë rrjedhëse në emër të bashkëshortit në "Raiffeisen Bank, trupi gjykues vlerëson se, duke marrë në konsideratë deklarinë në DPV-në e vitit 2007, deklarinë pranë ILDKPKI-së në vitin 2015 si dhe arsyetimin llogjik të veprimeve financiare me likuiditetet në bankë, e vlerësuar kjo në harmoni me deklarinë e subjektit para deklaratës vetting, duhet marrë në konsideratë për efekt të analizës financiare si burim i ligjshëm për krijimin e pavarësisht mos deklarinë të gjendjes cash në vitin 2006. Gjithsesi, e vlerësuar në aspektin deklarativ të gjendjes cash në DPV-në e vitit 2006, dhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në një sërë vendimesh, subjekti dhe bashkëshorti nuk kishin burime të ligjshme*

të mjaftueshme për shtimin e likuiditeteve dhe përballimin e shpenzimeve të periudhës në shumën prej -425,082 lekë.

- 2.51** Në lidhje me pretendimin se, “Në analizën financiare të pasqyruar në Rezultatet e Hetimit, nxirret diferenca prej 207.671 lekë, si pamundësi kursimi, ndërsa në analizën financiare përfundimtare, në vlerën totale të burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit, nuk zbritet diferenca e konstatuar si pamundësi kursimi, por zbritet e gjithë shuma prej 900.000 lekë. Komisioni duhet të zbriste, vetëm diferencën e konstatuar si pamundësi kursimi, vlerën prej 207.671 lekë”, komisioni vlerëson se, është i drejtë pretendimi i subjektit. Në këto kushte subjekti dhe bashkëshorti nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për shtimin e likuiditeteve dhe përballimin e shpenzimeve të periudhës 1 Janar 2008 deri në 13.05.2008, në shumën prej -207,671 lekë.
- 2.52** Në përfundim të vlerësimit mbi krijimin e shumave 600,000 lekë dhe 900,000 lekë nga burime të ligjshme, referuar analizimit të pretendimeve më lart, rezulton se, subjekti i rivlerësimit ka një mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 632,753 lekë, në datën e krijimit të këtyre llogarive.
- 2.53** Më tej në lidhje me deklarin e gjendjes cash komisioni arrin në përfundimin se, subjekti ka bërë deklarin të pasaktë lidhur me mosdeklarimin e gjendjes cash në deklaratën periodike të vitit 2006, detyrim ky i përcaktuar nga ligji 9049, datë 10.4.2003.

3. Gjendje llogarie bankare

3.1 Subjekti ka deklaruar llogari rrjedhëse pranë “Credins Bank”, e ardhur nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 24.1.2017¹³. Vlera 35.067,42 lekë. Pjesa takuese: 50%.

3.2 Nga nxjerrja e llogarisë në “Credins Bank”, llogari page, rezulton se, gjendja e llogarisë në datë 24.01.2017 ka qenë 35,067 lekë.

3.3 Në këto llogari janë kryer veprime lidhur me të ardhurat nga paga e subjektit ndër vite veprime që janë pasqyruar në analizën financiare.

3.4 Komisioni në përfundim nuk konstatoi problematika me këtë llogari bankare.

4. Gjendje llogarie bankare

4.1 Subjekti ka deklaruar gjendje në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortit të saj Q.Z në “Raiffeisen Bank”, e ardhur nga paga si inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë në datën 24.1.2017¹⁴. Vlera 103.198,92 lekë. Zotëron 50%.

4.2 Nga nxjerrja e llogarisë në “Raiffeisen Bank” rezulton se, në datë 10.12.2019, subjekti ka transferuar shumën 1,400,378 lekë për të shlyer kredinë, konfirmuar dhe nga gjendja e llogarisë dy emërore të subjektit dhe bashkëshortes së tij në “OTP Bank”.

Gjendja e llogarisë në datë 06.01.2017 ka qenë 103,198.92 lekë.

¹³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: Credins Bank (printim i datës 23.1.2017) të llogarisë në emër të shtetasës Vjosa Zaimi, me gjendje llogarie në datën 23.1.2017, në vlerën 35.067,42 lekë.

¹⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: Raiffeisen Bank (nxjerrje llogarie) për llogarinë në emër të shtetasit Q.Z me gjendje llogarie në datën 6.1.2017 në vlerën 103.004 lekë.

4.3 Në këto llogari janë kryer veprime lidhur me të ardhurat nga paga e bashkëshortit të subjektit ndër vite veprime që janë pasyruar në analizën finaciare.

4.4 Komisioni në përfundim nuk konstatoi problematika me këtë llogari bankare.

Deklarim i bashkëshortit të subjektit

5. Tokë bujqësore¹⁵ me sip. 19.650 m² e ndodhur në fshatin ***, rrethi Gramsh, Zona Kadastrale nr.***, Sip.19.650 m². Pjesa takuese: 1/7 pjesë.

Burimi i krijimit: Fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, si pjesëtar i familjes bujqësore.

5.1 Në datë 30.10.1992 me Aktin e marrjes së Tokës në pronësi nr. *** familja e z.P.K.Z, ka përfituar 19.930 m² tokë në fshatin *** (Gramsh), nga të cilat 19 630 m² tokë arë dhe 300 m² tokë truall.

Bazuar në shkresën e ZVRPP Gramsh konfirmohet se në pronësi të z. P.Z janë pasuritë e mëposhtme:

- Pasurinë “Arë” ndodhur në Z.K.***, nr.pasurie ***, me sip.6850m².
- Pasurinë “Arë” ndodhur në Z.K.***, nr.pasurie ***, me sip.950m².
- Pasurinë “Arë” ndodhur në Z.K.***, nr.pasurie ***, me sip.3700m².
- Pasurinë “Arë” ndodhur në Z.K.***, nr.pasurie ***, me sip.5800m².
- Pasurinë “Arë” ndodhur në Z.K.***, nr.pasurie ***, me sip.2050m².
- Pasurinë “Truall” ndodhur në Z.K.****, me nr. pasurie *** me sip.300m².

5.2 Nga verifikimi i deklaratave periodike dhe deklaratës VETTING nuk rezulton që, bashkëshorti i subjektit të ketë deklaruar se, ka përfituar të ardhura nga shfrytëzimi i kësaj toke bujqësore.

Ndërkohë, në përgjigje të pyetësorit të parë ai ka sqaruar se, *shpenzimet e jetesës në periudhën tetor 2001-31.12.2005 ai dhe familja e tij i kanë përballuar me pagën e tij të marrë, si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd, me pagën e marrë nga vëllai i tij, si punonjës në Policinë e Burgjeve në IEVP Peqin, si dhe me të ardhurat në formën e prodhimeve bujqësore të realizuara nga toka bujqësore...prindërit e tij gjatë periudhës tetor 2001-31.12.2005, kur ata kanë jetuar së bashku me të në qytetin e Elbasanit. Prindërit e subjektit nuk kanë qënë në marrëdhënie pune në këtë qytet, dhe as nuk kishin dalë në pension në atë kohë. Si rezultat, ata nuk i shpëputën lidhjet me tokën bujqësore në pronësi të tyre dhe në periudha sezonale, shkonin e punonin tokën dhe siguronin të ardhura në formën e prodhimeve bujqësore. Këto prodhime ishin në sasi relativisht të vogël, nuk janë përdorur për shitje në treg, por janë përdorur vetëm për konsumin e familjes.*

¹⁵ Praktika bashkëlidhur deklaratës: (i) Akti i marrjes së Tokës në pronësi, datë 30.10.1992; (ii) Çertifikatë për vërtetim pronësie e ZVRPP Gramsh, lëshuar datë 25.5.2007, për pasurinë “Arë” ndodhur në ZK.***, nr.pasurie ***; (iii) Çertifikatë për vërtetim pronësie e ZVRPP Gramsh, lëshuar datë 25.5.2007, për pasurinë “Arë” ndodhur në ZK.***, nr.pasurie ***; (iv) Çertifikatë për vërtetim pronësie e ZVRPP Gramsh, lëshuar datë 25.5.2007, për pasurinë “Arë” ndodhur në ZK.***, nr.pasurie ***; (v) Çertifikatë për vërtetim pronësie e ZVRPP Gramsh, lëshuar datë 25.5.2007, për pasurinë “Arë” ndodhur në ZK.***, nr.pasurie ***; (vi) Çertifikatë për vërtetim pronësie e ZVRPP Gramsh, lëshuar datë 25.5.2007, për pasurinë “Arë” ndodhur në ZK.***, nr.pasurie ***; (vii) Çertifikatë për vërtetim pronësie e ZVRPP Gramsh, lëshuar datë 25.5.2007, për pasurinë “Truall” ndodhur në ZK.***, nr.pasurie ***.

5.3 Bashkëshorti i subjektit e ka deklaruar këtë tokë, së bashku me një shtëpi banimi të ndërtuar nga prindërit e tij në vitin 1989 në fshatin G, që në DVP/2003.

5.4 Në përgjigje të pyetësorit të parë në lidhje me këtë shtëpi bashkëshorti i subjektit ka sqaruar se kur është plotësuar DVP\2003, ai jetonte bashkë me prindërit, motrën dhe vëllezërit e tij në të njëjtin trung familjar. Në këto kushte ata konsideroheshin si persona të lidhur, prandaj ka deklaruar pasurinë që figuronte në emër të familjes së tij. Trualli i banesës është përfituar me ligjin nr.7501 dt,19.07.1991 dhe është pjesë e tokës bujqësore të deklaruar nga ana e tij në Deklaratën VETTING.

5.5 Në përfundim Komisioni konstatoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.

KONSTATIME TË TJERA

6. Shtëpi banimi

6.1 Nga hetimi ka rezultuar se në në DVP/2003 subjekti ka deklaruar shtëpi banimi 2+1 me vlerë 1,500,000 lekë nr.pasurie *** në proces privatizimi. Pjesa takuese 0%.

6.2 Bazuar në procesverbalin¹⁶ e mbajtur më datë 11.02.2015, vënë në dispozicion nga ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se, pjesa takuese saj në këtë pasuri është 0 dhe se shuma 1,500,000 lekë është vlera e tregut.

6.3 Në lidhje me këtë apartament bashkëshorti i subjektit në përgjigje të pyetësorit të parë ka sqaruar se: *“Bashkëshortja në datën kur është dorëzuar DVP\2003, ka jetuar në të njëjtin trung familjar bashkë me prindërit e saj Xh dhe D.Ç, në qytetin e Përrenjasit, rrethi Librazhd. Në këto kushte ata konsideroheshin si persona të lidhur, prandaj bashkëshortja ka deklaruar pasurinë që figuronte në emër të prindërve të saj në atë kohë. Pasuria e vetme që prindërit e saj kanë pasur është apartamenti i banimit ku jetonin, e cila iu ka kaluar në pronësi me anë të privatizimit, sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Nga ana e bashkëshortes është deklaruar vlera e banesës prej 1.500.000 lekë. Kjo vlerë është vënë duke bërë një vlerësim me përafërsi të vlerës së tregut të banesave, në kohën e deklarimit, në qytetin Përrenjas, Librazhd. Pas përfundimit të azhurnimit të pasurive të paluajtshme është lëshuar çertifikata e pronësisë me nr. ***, datë 23.07.2001. Çertifikata është lëshuar në emër të bashkëpronarëve Xh.R.Ç dhe D.R.Ç”.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se, pronar të këtij apartamenti janë prindërit e subjektit dhe se ajo në datë 01.12.1992 ka qënë në përbërjen familjare të k/familjarit Xh.R.Ç, por në moshën 15 vjeçe. Pra, nuk ishte në moshë madhore dhe për pasojë nuk ka përfituar asnjë pjesë pronësie nga privatizimi i apartamentit të banimit.

6.4 Në përfundim, Komisioni konstatoi se, nuk rezultojnë problematika në lidhje me këtë pasuri.

7. Analiza financiare

7.1 Komisioni hartoi analizën financiare për subjektin e rivlerësimit znj.Vjosa Zaimi për periudhën e ushtrimit të funksionit si gjyqtare nga viti 2003 deri në vitin 2016.

7.2 Analiza financiare u bazuar në të ardhurat e subjektit të rivlerësimit në raport me shpenzimet, blerjet e pasurive dhe ndryshimet e likuiditeteve.

¹⁶ Shih shkresë e ILDKPKI-së nr.*** prot., datë 14.09.2020

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: VJOSA Xh. ZAIMI																
PERSHKRIMI	2000-2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	0	0	0	501,522	391,745	1,617,947	1,279,817	1,110,433	1,310,730	983,554	807,847	5,641,447	119,179	-118,798	47,154	13,692,579
Apartament 98.3 m2 - Rr. ****, Tirane - 2013 - 12,460,000 leke - 50%												11,560,000	900,000			12,460,000
Autoveture Peugeot TR****U - 2010 - 8,575€ - 50%									1,172,830							1,172,830
Toke bujqesore 19,650 m2, Gramsh - 1/7																0
Ndryshim ne likuiditet		0	0	501,522	391,745	1,617,947	1,279,817	1,110,433	137,900	983,554	807,847	-5,918,553	-780,821	-118,798	47,154	59,749
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4,700,000	-363,927	-502,178	-531,737	3,302,158
Hua marre nga F. H. - 2013 - 4,700,000 leke												4,700,000	-4,664,000			36,000
Kredi Societe General - 2014 - 4,700,000 leke													4,300,073	-502,178	-531,737	3,266,158
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	0	0	0	501,522	391,745	1,617,947	1,279,817	1,110,433	1,310,730	983,554	807,847	941,447	483,107	383,380	578,891	10,390,421
																0
TE ARDHURA dokumentuar	615,060	594,083	869,702	911,521	2,026,812	2,138,384	2,272,839	2,528,390	2,363,592	2,340,975	2,467,329	2,181,779	2,328,011	2,314,503	2,454,172	28,407,151
Te ardhura nga puna subjekti Vjosa Zaimi	615,060	594,083	869,702	873,934	834,227	803,562	777,480	811,594	836,666	842,015	993,546	953,300	1,157,161	1,095,337	1,234,992	13,292,659
Te ardhura nga puna Q. Z.					886,832	1,174,691	1,208,125	1,355,012	1,222,018	1,143,490	1,153,471	1,153,850	1,170,850	1,219,166	1,219,180	12,906,685
Te ardhura nga pasuri te bashkeshortit para martesë					305,753											305,753
Te ardhura nga interesi ne bono thesari Vjosa Zaimi				37,587				60,732	50,571	50,151	44,610	25,601				269,252
Te ardhura nga interesi ne bono thesari Q. Z.						139,431	287,234	301,052	254,337	305,319	275,702	49,027				1,612,102
Te ardhura nga interesi i depozitave						20,700										20,700
SHPENZIME	317,796	150,964	135,964	151,557	535,817	564,235	1,064,714	740,860	695,860	854,403	979,734	1,099,751	1,835,621	1,598,408	1,308,122	11,716,010
Shpenzime jetese	302,796	93,964	93,964	109,557	219,114	318,780	788,714	409,860	409,860	529,403	558,192	564,096	879,992	897,104	940,368	6,812,968
Shpenzime per tatim kalim pronesie - 2014													143,668			143,668
Shpenzime shkollimi per femijet						3,000	18,000	18,000	18,000	18,000	28,000	237,004	408,140	454,245	157,137	1,341,527
Shpenzime arredimi banese				25,000	25,000	25,000	25,000	25,000	25,000	25,000	25,000	25,000	150,000			350,000
Shpenzime interesi dhe komisioni per kredine S. Generale													253,820	241,223	210,617	705,661
Shpenzime transport i brendshem Vjosa Zaimi						8,000	48,000	48,000	42,000							146,000
Shpenzime qiraje	15,000	57,000	42,000	42,000	168,000	160,000	240,000	240,000	195,000	240,000	240,000	240,000				1,864,000
Shpenzime mjekesore Vjosa Zaimi											33,533	11,217				44,750
Shpenzime udhetimi				123,703	60,455	0	0	0	0	0	95,010	22,434	0	5,836	0	307,437
Analiza dokumentuar	297,264	443,119	733,738	258,442	1,099,250	-43,798	-71,692	677,097	357,002	503,019	679,747	140,581	9,283	332,716	567,158	5,685,660
													Pamundësia totale financiare			-115,491

Nga analiza financiare, subjekti rezulton në një pamjaftueshmëri totale të burimeve të ligjshme në vlerën 115,491 lekë. Pamundësia financiare prej -115,491 lekë, nuk konsiderohet nga Komisioni penalizuese për subjektin e rivlerësimit.

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare.

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: Raiffeisen Bank, BKT, Credins Bank, Union Bank, Tirana Bank, Societe General Bank, Banka e Shqipërisë (Bono Thesari) si dhe gjendjet cash të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

(i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në: Shkollën e Magjistraturës (2000 – 2002), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan (2002 – 2003), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (2003 – 2011), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (2011 – 2016), raportat e barrëindjes (2014 – 2015); (ii) Të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit në: Shkollën e Magjistraturës (1998 – 2000), Gjykatën e Rrethit Elbasan (2000 – 2001) dhe 2007, Gjykatën e Rrethit Librazhd (2001 – 2007), KLD (2007 – 2016); (iii) Të ardhurat nga interesi nga depozitat dhe nga bonot e thesarit tek Banka e Shqipërisë (2005 – 2013); (iv) Të ardhurat e pretenduara nga subjekti të mara nga U dhe Shkolla e Magjistraturës nuk dokumentohen si arkëtime dhe nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura. Nqs subjekti do vërtetojë këto të ardhura, ato do bëhen pjesë e analizës financiare.; (v) Të ardhura nga pasuri paramartesorë të bashkëshortit (2006)

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

(i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT); Përfashtim bën viti 2008 për të cilin shpenzimet e jetesës ndryshojnë sipas sqarimit të bërë tek pika 2.32 në këtë relacion.

(ii) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (J.R.) dt. 22/05/2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/ bashkëshorti kanë deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrimi pranë të afërmeve; (iii) Shpenzime arredimi banese (2006-2014), të deklaruara nga vetë subjekti në përgjigje pyetësoril (iv) Shpenzime shkollimi të fëmijëve të deklaruara nga vetë subjekti në përgjigje pyetësori (2008 – 2016); (v) Shpenzim qiraje të subjektit vetëm si dhe të përbashkëta me bashkëshortin, të deklaruara nga subjekti në përgjigje pyetësori (2000 – 2013).; (vi) Shpenzime mjekësore (2012 - 2013) sipas përgjigjeve të subjektit përgjigje pyetësori; (vii) Shpenzime për tatim kalim pronësie (2014); (viii) Shpenzime interesi dhe komisione për kredinë tek Societe General Albania (2014 – 2016); (ix) Shpenzime për transport të brendshëm (ndërrqytetas) për subjektin për periudhën e punës larg qendrës së banimit (2008 – 2011).

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/ shitblerjeve të këtyre pasurive¹⁷.

Konkluzioni në lidhje me kontrollin e pasurisë

7.3 Si konkluzion, trupi gjykues çmon se mungesa e likuiditeteve përgjatë viteve, pas analizës financiare të përditësuar në shumën 868.961 lekë, në momentin e krijimit të pasurive, nuk është në masën që të përbëjë shkak për shkarkimin e subjektit, për vetë faktin se analiza financiare

¹⁷ Shih kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson, krahasuar me aspektet konkrete të jetës reale.

- 7.4** Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- 7.5** Komisioni, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij. Komisioni konkludon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- 7.6** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë bindshëm burimin e krijimit të pasurive të saj, pavarësisht mungesës së burimeve financiare në shumën 868.961 lekë për krijimin e pasurive për një hark kohor prej 10 vjetësh . Këto pasaktësi gjatë këtyre katër viteve, sipas vlerësimit të trupit gjykues, nuk përbëjnë çënim të besimit të publikut dhe nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkim, sipas pikës 61/3, pasi deklarimi në deklaratën “Vetting” është i saktë dhe ka burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë e deklaruara nga burime të ligjshme.

B. KONTROLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, mne anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim DSIK ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit Nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Si konkluzion DSIK ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit znj. Vjosa Zaimi.

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Vjosa Zaimi, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta dhe nuk ka pasur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale është përgaditur bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr.

96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) Aftësitë profesionale;
- b) Aftësitë organizative;
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) Formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet si vijon:

Formulari paraqitet i plotë dhe i nëshkruar pa mangësi e kundërthënie, sipas shtojcës që parashikon ligji.

Subjekti i rivlerësimit Vjosa Zaimi, në periudhën janar 2006-31.08.2007, ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kolonjë. Në periudhën shtator 2007-shtator 2008, ka qënë gjyqtare në dispozicion për shkak të suprimimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kolonjë. Në periudhën shtator 2008-nëntor 2011, ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ndërsa nga nëntori 2011 e aktualisht, vijon detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. e në 3 vitet e fundit ka kryer detyrën në fushën e të drejtës civile, seksioni familjar.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në periudhën 4 vjeçare 2013 - 2016 i janë caktuar 2113 çështje; ka përfunduar 1803 çështje; ka mbartur gjithsej 88 çështje të vitit 2016.

Subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë, në 8 trajnime që i përkasin periudhës së rivlerësimit në tre vitet e fundit.

Sipas formularit të vetëvlerësimit, rezultoi se gjyqtarja Vjosa Zaimi, ka marrë pjesë edhe në një trajnim jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, në të cilin ajo ka qënë në cilësinë e ekspertës dhe konkretisht në trajnimin me temë: “Trajnim për dhunën me bazë gjinore për avokatët dhe shoqërinë civile”, i organizuar nga U, P.F.T.F, U.W, B.R.R.L.N, më 07-09 qershor 2016, në qytetin e Pogradecit. Për këtë trajnim subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe programin e trajnimit që është pjesë e dosjes së rivlerësimit.

Për periudhën e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tre dokumente ligjore, të llojit vendim gjyqësor. Të tria vendimet i përkasin vitit 2014.

Dokumenti 1 - Vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 02.04.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditës “Raiffeisen Bank” Sh.a kundër të paditurve Shoqëria “****” dhe Shoqëria “****” sh.p.k, person i tretë: Zyra Përmbarimore “****” sh.p.k, me objekt: “kundërshtimin dhe shfuqizimin e vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë”.

Dokumenti 2 - Vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 09.06.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditës shtetasi A.T, kundër të paditurve Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, R.H, person i tretë Zyra Qëndrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Tiranë, me objekt “detyrimi i palës së paditur ZRPP Tiranë të korrigjojë hartën treguese të rregjistrimeve për Zonën Kadastrale ***, etj.

Dokumenti 3. Vendimi gjyqësor civil nr. ***, datë 17.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditës shtetasin R.Y, kundër të paditurës E.Y, me objekt “Zgjidhja e martesës. Lënia për rritje dhe edukim e fëmijës së mitur E.Y mua paditësit. Ndryshimi i mbiemrit të të paditurës nga Y në D”.

PËRSHKRIMI I 5 DOSJEVE GJYQËSORE PËR GJYQTAREN VJOSA ZAIMI TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

Dosja 1 - Çështja civile familjare që ju përket paditëse A.B, kundër të paditurit P.B, me objekt “zgjidhjen e martesës për faj të të paditurit P.B. Lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim etj”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 29.06.2016.

Çështja me shortin e datës 23.09.2015 i është caktuar gjyqtarës Vjosa Zaimi. Me vendim të datës 25.09.2015, caktoi seancën përgatitore (pajtimi) në datën 14.10.2015, ora 11.30. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme.

Ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 29.06.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke e ndryshuar atë vetëm sa i përket fajësisë për zgjidhjen e martesës dhe duke përcaktuar se martesa zgjidhet me faj të të paditurit P.B.

Bazuar në numratorin e vendimeve civile dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në k/sekretari në datë 11.07.2016, 12 ditë nga shpallja, jashtë afatit 10 ditor të parashikuar nga neni 308 paragrafi 2 i K.Pr.Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 9 muaj e 8 ditë, në intervalin kohor 21.09.2015– 29.06.2016. Kohëzgjatja e gjykimit është jashtë afatit standard 4 mujor të përcaktuar nga pika 5 shkronja “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 29.06.2016, është dhënë nga gjyqtarja Vjosa Zaimi, në cilësinë e gjyqtarës së vetme. Vendimi përmban elementët e nenit 310 të K.Pr.Civile dhe është i ndarë në pjesën *hyrëse*, pjesën *përshkruese-arsyetuese* dhe në *dispozitivin* e gjykatës. Ai paraqitet me strukturë të qartë, dhe të kuptueshme.

Dosja 2 - Çështja civile, që i përket paditëse J.Zh (P), kundër të paditurit A.Zh, me objekt: zgjidhjen e martesës mes palëve”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 10.11.2014, i është caktuar gjyqtarës Vjosa Zaimi, e cila ka gjykuar si gjyqtare e vetme. Rezultoi se ndaj vendimit nuk është paraqitur ankim nga palët ndërgjyqëse.

Bazuar në numratorin e vendimeve civile dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në k/sekretari në datë 12.11.2014, 2 ditë nga shpallja, brenda afatit 10 ditor të parashikuar nga neni 308 paragrafi 2 i K.Pr.Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 5 muaj e 18 ditë, në intervalin kohor 26.05.2014-10.11.2014. Kohëzgjatja e gjykimit është jashtë afatit standard 4 mujor të përcaktuar nga pika 5 shkronja “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Në procesverbalin gjyqësor janë pasqyruar të plota vendimet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit, si dhe dispozitivi i vendimit përfundimtar. Dosja është e inventarizuar rregullisht dhe renditja e akteve nuk vështirëson përdorimin e saj. Procesverbali gjyqësor tregon se komunikimi i

subjektit të rivlerësimit, përse i përket kërkesave paraprake, leximit të të drejtave dhe detyrave dhe dhënia e fjalës palëve sipas radhës ka qenë i qartë.

Vendimi përmban elementët e nenit 310 të K.Pr.Civile dhe është i ndarë në pjesën *hyrëse*, pjesën *përshkruese-arsyetuese* dhe në *dispozitivin* e gjykatës. është gjykuar në mungesë), por edhe mbi bazën e provave të administruara gjatë gjykimit. Ai paraqitet me strukturë të qartë dhe të kuptueshme.

Dosja 3 - Çështja civile, që i përket paditës G.D, kundër të paditurës D.R, me objekt: Zgjidhje e martesës për ndërprerje të jetës bashkëshortore”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 05.05.2016. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme.

Rezultoi se ndaj vendimit nuk është paraqitur ankim nga palët ndërgjyqëse.

Bazuar në numratorin e vendimeve civile dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në k/sekretari në datë 13.05.2016, 8 ditë nga shpallja, brenda afatit 10 ditor të parashikuar nga neni 308 paragrafi 2 i K.Pr.Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 6 muaj e 20 ditë, në intervalin kohor 15.10.2015-05.05.2016. Kohëzgjatja e gjykimit është jashtë afatit standard 4 mujor të përcaktuar nga pika 5 shkronja “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Në lidhje me menaxhimin e çështjes nga ana e gjyqtarës nuk konstatohen probleme. Gjykimi është zvarritur për shkaqe të pavarura nga gjyqtarja. Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk konstatohen të meta. Në dosje janë përfshirë rregullisht kërkesëpadiat, vendimi për kalimin e çështjes në seancë përgatitore e gjyqësore, aktet e njoftimit për palët, procesverbali i seancave të pajtimit dhe procesverbali i seancave gjyqësore, provat shkresore, vendimi gjyqësor përfundimtar etj. Aktet e prodhuara nga gjykata janë të rregullta nga ana formale.

Vendimi përmban elementët e nenit 310 të K.Pr.Civile dhe është i ndarë në pjesën *hyrëse*, pjesën *përshkruese-arsyetuese* dhe në *dispozitivin* e gjykatës. Ai paraqitet me strukturë të qartë dhe të kuptueshme.

Dosja 4 - Çështja civile, që i përket paditëses R.L, kundër të paditurit A.L, me objekt: vërtetimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes. Kjo çështje është përfunduar me vendimin nr. ***, datë 08.08.2015. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme, ku në fund ka vendosur:

Pranimin e kërkesëpadiës dhe Vërtetimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes të dhënë nga gjykata me vendimin 05.08.2015.

Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim nga palët ndërgjyqëse.

Bazuar në numratorin e vendimeve civile dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në k/sekretari në datë 10.08.2015, 2 ditë nga shpallja e vendimit për vërtetimin e urdhërit të mbrojtjes.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, nuk parashikon afat për arsyetimin e vendimit për vërtetimin e urdhërit të mbrojtjes, ndërkohë që parashikon afat për rastin e vendimit me të cilin lëshohet urdhëri i menjëhershëm i mbrojtjes.

Rezulton se, është respektuar afati ligjor për arsyetimin dhe dorëzimin e vendimit për vërtetimin e urdhërit të mbrojtjes. Gjyqtarja e çeli dhe e përfundoi gjykimin në një seancë të vetme.

Vendimi përmban elementët e nenit 310 të K.Pr.Civile dhe është i ndarë në pjesën *hyrëse*, pjesën *përshkruese-arsyetuese* dhe në *dispozitivin* e gjykatës. Ai paraqitet me strukturë të qartë dhe të kuptueshme.

Dosja 5 - Çështja civile, që i përket paditësve M.P e S.P, kundër të paditurve A.M, shoqëria “***” sh.p.k, Y.M, me objekt: “Kërkohet zgjidhja e kontratës së sipërmarrjes nr. *** me nr. ***, datë 16.06.2007 dhe kthimin e palëve në gjëndjen e mëparshme. Zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.04.2006 dhe kthimin e palëve në gjëndjen e mëparshme”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 16.12.2013. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme.

Ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 18.06.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. *** datë 16.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kundër vendimit është paraqitur rekurs dhe sipas printimit të datës 27.10.2021 nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, çështja është ende në pritje për gjykim.

Bazuar në numratorin e vendimeve civile dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në k/sekretari në datë 30.12.2013, 14 ditë nga shpallja, jashtë afatit 10 ditor të parashikuar nga neni 308 paragrafi 2 i K.Pr.Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 9 muaj e 7 ditë, në intervalin kohor 07.03.2013-16.12.2013. Kohëzgjatja e gjykimit është jashtë afatit standard 4 mujor të përcaktuar nga pika 5 shkronja “d” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Vendimi përmban elementët e nenit 310 të K.Pr.Civile dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës. Ai paraqitet me strukturë të qartë dhe të kuptueshme.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-SË

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja Vjosa Zaimi është diplomuar në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Fakultetit të Shkencave Humane, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan më datë 13.07.2000 dhe ka përfunduar shkollën e Magjistraturës në vitin 2003. Me vendimin nr. ***, datë 21.10.2002 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, emërohet provizorisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Me Dekret nr. ***, datë 21.10.2003 të Presidentit të Republikës, emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Ersekë. Me vendim nr. ***, datë 24.10.2008 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pas diskutimit mbi gjykatat e suprimuara, në bazë të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. ***, datë 11.06.2007 “Për krijimin e rretheve gjyqësore, caktimin e kompetencave tokësore të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre”, dhe në zbatim të vendimit nr. ***, datë 08.09.2008, për ushtrimin e detyrës së gjyqtarëve pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, të cilat mbulojnë veprimtarinë territoriale të gjykatave të suprimuara, në plotësim të tij, vendosi gjyqtare Vjosa Zaimi të ushtrojë detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Me vendim nr. ***, datë 14.11.2011 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë transferohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.

Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Vjosa Zaimi është paraqitur 1 ankesë në vitin 2014 në Inspektoratin e ish KLD-së. Ankesa e vitit 2014 verifikuar për zvarritje gjykimi është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Vjosa Zaimi përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli.

ANALIZA E GJETJEVE

Subjekti i rivlerësimit Vjosa Zaimi, ka shfaqur aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi profesional gjyqtarja Vjosa Zaimi ka punuar në dhomën civile, pjesërisht në seksionin civil dhe pjesën më të madhe të kohës në seksionin familjar. Në të drejtën civile, gjyqtarja zgjidh drejt mosmarrëveshjet objekt gjykimi dhe vendimi i dhënë prej saj lihet në fuqi nga gjykatat më të larta. Në të drejtën civile, gjyqtarja ka njohuri në lidhje me paditë në fushën tregtare ku njëherazi ka trajtuar edhe pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik.

Gjithashtu, gjyqtarja Vjosa Zaimi, ka njohuri edhe në të drejtën familjare. Ajo zgjidh drejt mosmarrëveshjet në fushën familjare dhe vendimet e saj lihen në fuqi pas ankimit ose nuk ankimohen nga palët.

Nga ana tjetër, ndër 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, janë ankimuar 5 prej tyre dhe në katër raste, vendimi i dhënë nga gjyqtarja Vjosa Zaimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.

Subjekti i rivlerësimit Vjosa Zaimi, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre.

Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, duke treguar se gjyqtarja ka qënë e vëmëndshme ndaj kërkesave të tyre. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standartin e procesit të rregullt ligjor.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, gjyqtarja Vjosa Zaimi, ka përfunduar së gjykuari 1255 çështje. Nga ky total, 70 çështje janë civile të përgjithshme, 1 çështje është civile tregtare, 706 janë çështje civile familjare, 474 çështje janë kërkesa civile dhe 4 çështje janë penale masa sigurimi.

Referuar nenit 3 gërma “d” të Aneksit 1, gjyqtari i dhomës civile të seksionit familjar, duhet të gjykojë jo më pak se 200 çështje që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje familjare, që do të thotë 600 çështje për tre vite të rivlerësimit. Ndërkohë, rezulton se gjyqtare Vjosa Zaimi për 3 vjet, ka përfunduar së gjykuari 706 çështje mosmarrëveshje familjare. Si rezultat, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe tejkaluar standartin sasior sa i takon çështjeve familjare të gjykuara.

Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Vjosa Zaimi, ka qënë në intervale kohore të ndryshme.

Në 5 dosje të vëzhguara, është konstatuar se në katër raste nuk është respektuar afati standard i gjykimit. Nga analiza e dosjeve për të cilat nuk është respektuar afati standart i gjykimit, është konstatuar se tejkalimi i këtij afati nuk lidhet me mangësi në organizimin dhe planifikimin e punës nga ana e gjyqtares Vjosa Zaimi. Në asnjë rast nuk është konstatuar përpjekje e gjyqtares për zvarritje të procesit, nuk konstatohet shtyrje e pajustificuar e seancave apo distanca të gjata kohore midis tyre, por dështimi i seancave lidhet me pamundësitë e njoftimit të palëve prej shërbimit postar, shtyrje e seancave për mosparaqitje të palëve apo më kërkesë të tyre për të marrë prova të reja etj.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Vjosa Zaimi, është eficient dhe efektive në çështjet që ajo ka shqyrtuar.

Subjekti i rivlerësimit Vjosa Zaimi, ka aftësitë e duhura për të kryer procedurat gjyqësore në pesë dosjet e vëzhguara. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj duke nxjerrë vendime formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore.

Në çështjen me objekt lëshim i urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes, gjyqtarja ka respektuar afatin ligjor për shqyrtimin e çështjes. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se gjyqtarja Vjosa Zaimi, nxjerr urdhër apo vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Vjosa Zaimi.

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Vjosa Zaimi, komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse.

- Në vijimësi të gjetjeve profesionale nga ana e Komisionit, u konstatua se, në lidhje me dokumentin 3 të zgjedhur nga subjekti i rivlerësimit gjykimi i çështjes nga data e regjistrimit deri në datën e dhënies së vendimit përfundimtar ka zgjatur 3 vjet, 10 muaj e 17 ditë, në intervalin kohor 23.07.2010-09.06.2014. Rezulton se gjykimi, është realizuar në tejkallim të afatit standard 6 mujor, të përcaktuar nga pika 5 shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

- Ndërsa në lidhje me çështjen civile, që i përket dosjes nr. ***, të përzgjedhur në mënyrë objektive e rastësore, me paditës G.D, kundër të paditurës D.R, me objekt: Zgjidhje e martesës për ndërprerje të jetës bashkëshortore”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 05.05.2016, Komisioni konstatoi numrin e madh të seancave përgatitore të zhvilluara të cilat nuk kanë qënë produktive. Konstatohet se nuk janë bërë përpjekje shteruese në kuptim të K.Pr.Civile për ta njoftuar palën paditëse, qoftë edhe nëpërmjet adresës elektronike apo thirrjes telefonike të të paditurit në proces. Nga 7 seanca përgatitore, 5 pesë prej tyre nuk kanë qënë produktive, çfarë ka çuar në zvarritjen dhe zgjatjen e procesit te një afati të arsyeshem.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme subjektit të rivlerësimit ju kërkua shpjegime përkatëse bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

Pas përgjigjeve dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti,¹⁸ Komisioni nuk konstatoi problematika për të cilën mund të penalizohet subjekti i rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit profesional.

DENONCIMET

Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur gjithsej 4 denoncime.

1.Denoncim i nr. * prot., datë 5.2.2019, shtetasit A.L**

Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për faktin se; *duke qënë kryesuese e trupit gjykues nuk ka bërë pjesë të procesit edhe denoncuesin A.L dhe babain i tij Y.L për arsye se, ata ishin pjesë e çertifikatës së pronësisë të pronave që paditësja kërkonte të administronte. Në këtë*

¹⁸ Shiko përgjigjet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit

mënyrë gjyqtarja ka cënuar direkt të drejtën e palëve dhe garantimit të një procesi të drejtë dhe të rregullt gjyqësor.

Denoncuesi bashkëlidhur vendimin nr. ***, datë 14.7.2015, ku gjykata ka vendosur: Pranimin e kërkesës, lëshimin e autorizimit kërkuës L.L për të kryer veprime juridike të administrimit të jashtëzakonshëm pa pëlqimin e Y.L për pasuritë si vijon:

Paraqitja e rrethanave të çështjes shkurtimisht: Shtetasit Y.L dhe L.L janë bashkëshortë dhe nga kjo martesë kanë dy fëmijë A dhe A.L. Gjatë viteve 2007 e deri në vitin 2014 L.L, për shkak të konflikteve të vazhdueshme kishte kërkuar 3 herë urdhër mbrojtje dhe në vitin 2014, ish bashkëshorti dhe djali i tyre e kishin kërcënuar Liljanën dhe plagosur rëndë përfaqësuesin ligjor të saj. L e Y.L i janë nënshtruar procesit të zgjidhjes së martesës e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët bashkëshortore që në vitin 2007. Y.L e ka ankimuar vendimin nr. *** datë 10.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të zgjidhjes së martesës dhe pjesëtimit të pasurisë bashkëshortore. Dhe çështja ishte në Gjykatën e Apelit për shkak të ankimit të bërë nga Y.L ndaj këtij vendimi të sipërcituar të vitit 2014.

Gjatë martesës shtetasit Y e L.L kishin krijuar disa pasuri të paluajtshme së bashku. L.L pretendon se, ata kanë marrë disa kredi së bashku duke vënë kolateral në banka pikërisht këto pasuri. Kur Y.L i kërkon të marrin një kredi të katërt ajo dyshon dhe për këtë i drejtohet komisarit të policisë sepse pronat tashmë po vireshin në ekzekutim nga përmbarimi me çmim simbolik në krahasim me vlerën reale të tyre. L pretendon se, Y e A.L kanë terrorizuar e ushtruar dhunë psikike e fizike ndaj saj dhe djalit të tyre A.L. Dhe në këto kushte është pajisur përsëri me urdhër mbrojtje. Ndërkohë Y.L duke qënë me masën e sigurimit personal “arrest në shtëpi” për kryerjen e veprës penale “Kundërshtim dhe goditje gjyqtari, të kryer në bashkëpunim”, kërcënon L.L dhe aty gjykata urdhëron arrestimin e tij në flagrancë.

Ndodhur në këto kushte, kur shtetasi Y.L ka kryer fallsifikime kontratash të pasurive të paluajtshme, ka ushtruar dhunë verbale e fizike me qëllim dhënien e pasurive në favor të tyre e duke parë edhe rrezikshmërinë në vazhdimësi, L. L në referim të nenit 58, 61 e 92 të Kodit të familjes si dhe nenit 10/1 të ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ku thuhet se, - *për sa kohë urdhri mbrojtës është në fuqi, trajtimi i pasurisë kryhet në përputhje me Kodin e Familjes, nenet 57, 58 dhe 60, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën: Lëshimin e autorizimit në favor të kërkuës për kryerjen e veprimeve juridike të administrimit të jashtëzakonshëm pa pëlqimin e Y.L të pasurive bashkëshortore (një numër i caktuar pasurish).* Kodi i Familjes, neni 58 thotë, - *Çdo bashkëshort mund të autorizohet nga gjykata për të kryer një veprim juridik, për të cilin bashkëpunimi ose pëlqimi i bashkëshortit tjetër do të ishte i nevojshëm, në qoftë se ky i fundit nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij ose në qoftë se refuzimi i tij vjen në kundërshtim me interesin e familjes. Veprimi juridik i kryer si më sipër, mund të kundërshtohet nga bashkëshorti, pëlqimi i të cilit nuk është marrë, për të mos e ngarkuar atë me asnjë detyrim.*

Ndodhur në këto kushte, gjykata me kryesuese gjyqtare Vjosa Zaimi, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes dhe ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, me argumentimin se, “*duhet të merren masa urgjente të tjetërsimit pa pëlqimin e Y.L pasi tjetërsimi i pasurive objekt kërkesë garanton përfitimin e vlerës reale të sendeve sipas çmimit të tregut e cila është dukshëm më e madhe në raport me vlerën që do të përfitohej nga shitja e këtyre sendeve me procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm*”, vendos lëshimin e autorizimit kërkuës L.L për të kryer veprime juridike të administrimit të jashtëzakonshëm lidhur me tjetërsimin e pasurive për përmbushjen e detyrimeve ndaj të tretëve, pa pëlqimin e bashkëshortit Y.L për pasuritë objekt gjykimi.

Ndodhur në këto kushte, dhe sa u parashtrua më lart, Komisioni çmon se, nuk kemi të bëjmë me shkelje nga ana e subjektit të rivlerësimit, në shqyrtimin dhe vlerësimin e kësaj çështje.

2. Denoncim nr. * prot., datë 16.1.2020, i shtetasit J.B.**

Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit se, *në vitin 2013 ka lëshuar urdhër ekzekutimi pa asnjë provë dhe në shkelje të ligjit.*

Por, duke qënë se, denoncuesi nuk paraqet më gjatë situata e rrethana të caktuara apo nuk citon një vendim, ku subjekti i rivlerësimit të mund të hetohet për shkelje procedurale konkrete, Komisioni konstatoi se nuk rezultojnë shkaqe për tu hetuar më tej.

3. Denoncim nr. * prot., datë 1.6.2018, i shtetasit S.T.**

Ky denoncues ka denoncuar subjektin e rivlerësimit *për dhënie vendimi të gabuar sepse nuk ka pasqyruar provat (raportin mjeko ligjor prej 9 ditësh) dhe se qëllimisht nuk e ka pasqyruar raportin mjekësor.* Bashkëlidhur ankuesi ka sjellë edhe vendimin nr. *** datë 18.6.2014 me objekt lëshimin e urdhërit të mbrojtjes me paditës F.Ç dhe të paditur G. Ç, si dhe një dëshmi mjeko-ligjore nr. ***, datë 17.3.2014, ku konkludohet se, F.Ç ka pësuar dëmtime shëndeti të cilat hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të cilat sjellin humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën deri në 9 ditë.

Shkurtimisht nga përmbajtja e vendimit rezultoi: F.Ç është motra e G.Ç, për të cilin ka kërkuar urdhër mbrojtje ndaj tij për shkak se, kur ka shkuar tek banesa ku jeton edhe nëna e tyre, i vëllai G dhe i biri i tij E kanë ushtruar dhunë psikologjike dhe fizike ndaj motrës së tij F. Paditësja pretendon se, banesën ku ka shkuar ajo, ia ka lënë i ati me kontratë. Të njëjtin pretendim pronësie ka edhe i vëllai. Ndërkohë denoncuesi S.T është bashkëjetuesi i paditëses F.Ç, ku kjo e fundit ka kërkuar urdhër mbrojtje edhe për bashkëjetuesin me pretendimin se, kur ai ka ardhë në ndihmë të F, i vëllai i F ka ushtruar dhunë edhe ndaj tij gjithashtu. Ndërkohë gjyqtarja ka lëshuar urdhër mbrojtje për F dhe jo për bashkëjetuesin e saj.

Ndërsa për të kaluar tek pretendimi i denoncuesit S.T në lidhje me mosmarrjen parasysht të provës, dëshmi mjeko-ligjore nr. ***, datë 17.3.2014 për dëmtimet e shëndetit të shkaktuara F.Ç, sipas të cilit “*gjyqtarja vërtetohet se është e korruptuar përderisa ka dhënë këtë vendim*”, ky pretendim i denoncuesit nuk qëndron dhe nuk mund të merret për bazë për dy arsye: Së pari: Gjyqtarja ka dhënë një vendim në favor të kërkesës së paditëses dhe jo kundra saj, çka hedh poshtë pretendimin se, “*gjyqtarja është e korruptuar*” dhe së dyti: Fatkeqësisht duke parë arsyetimin e vendimit vërehet se, më datë 30.5.2014 për nënën e F dhe G.Ç, N.Ç, gjykata ka lëshuar urdhërin e mbrojtjes për N.Ç kundër F. Ç. Ndërkohë, dëshmia mjeko-ligjore për dëmtimet e shëndetit mban datën 17.3.2014, çka duket se, ky dokument është lëshuar kohë më parë se të jepej vendimi nga ana e subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë që, vendimi që sjell ankuesi mban datën 18.6.2014 dhe ky dokument si i tillë nuk mund të shërbente për procesin e gjykuar nga subjekti i rivlerësimit.

Pas vlerësimit të këtij denoncimi, konstatohet se, nuk ka asnjë indicie të vetme për të hetuar në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

4. Denoncim nr. * prot., datë 4.3.2019, i shtetases E. Sh.**

Kjo denoncuese ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për faktin se, *ajo ka shtyrë tre herë seancat gjyqësore për arsye të mos paraqitjes së paditësit me pretendimin se nuk është njoftuar, kur në fakt duhej të kishte pushuar çështjen si dhe përderisa procesi i divorcit kishte filluar në Itali dhe palët jetonin atje, nuk kishte përse ta zhvillonte gjyqin në Shqipëri.* Gjithashtu, denoncuesja ankohet edhe për mënyrën e intervistimit të së bijës nga psikologja, pa marrë miratimin e nënës së saj si dhe faktin se, psikologja ka zhilluar intervistën nëpërmjet skype pa theksuar se në çfarë gjuhe është zhvilluar intervista.

Bashkëlidhur kësaj ankese denonuesja sjell kopje të proces verbaleve të zhvillimit të procesit gjyqësor, kopje të kërkesë padisë, kopje të vendimit gjyqësor, kopje të kërkesës së denoncueses për gjykatën, ku kërkon depozitimin e kopjes të vërtetimit të Gjykatës Italiane (për fillimin e procesit të divorcit në shtetit Italian) dhe pamundësisë së saj për tu paraqitur në seancë gjyqësore, si dhe kopje të vlerësimit psikologjik për vajzën e mitur.

Për këto konstatime si më sipër, subjektit ju kërkuan shpjegime për veprimet procedurale të kryera nga ana e saj në lidhje me ecurinë e këtij procesi gjyqësor. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁹ subjekti dha shpjegime, që për Komisionin u konsideruan shpjegime bindëse.

Në përfundim Komisioni nuk konstatoi problematikë lidhur me denoncimet e bërë ndaj subjektit të rivlerësimit Vjosa Zaimi.

KONKLuzioni Përfundimtar:

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Vjosa Zaimi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jakobs, dhe referuar gurmës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

¹⁹ Shiko përgjigjet e dërguara nga subjekti mbi rezultatet e hetimit

V E N D O S I:

- 1.** Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Vjosa Zaimi.
- 2.** Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
- 3.** Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
- 4.** Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 9.12.2021.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Pamela Qirko

Kryesuese

Etleda Çiftja

Anëtare

Roland Ilia

Relator

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi